



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

THIRRJE PËR APLIKIM

Grante në kuadër të Programit
“Fondi Zhvillimor për Ndërmarrjet Mikro dhe të vogla”

Mars, 2025

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik (DZHE) në Komunë të Gjakovës, në bazë të nenit 9 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës nr. 01-110/01-3560, në kuadër të Programit "Fondi Zhvillimor për Ndërmarrjet Mikro" shpall këtë thirrje për aplikim për GRANTE të bizneseve lokale mikro të angazhuara në fushë të prodhimit, përpunimit dhe artizanateve tradicionale.

Qëllimi i Programit "Fondi Zhvillimor për Ndërmarrjet Mikro" është që të ndikojë në gjenerimin e vendeve të punës, përmirësimin e mirëqenies sociale, si dhe zhvillimin ekonomik lokal të Komunës së Gjakovës.

Granti do të ndahet në dy Lot-e si vijon:

Lot 1 – Start-up;

Lot 2 – Ndërmarrjet mikro dhe të vogla

Vlera e financimit të një Granti

Lot 1 – Start-up; nga 2,000 deri në 4,000 Euro

Lot 2 – Ndërmarrjet mikro dhe të vogla nga 4,000 deri në 8,000 Euro

Sqarim: Sipas kategorizimit të ATK-së dhe sipas Ligjit Nr.04/L-220 për Investime të Huaja, ndërmarrjet mikro dhe të vogla kategorizohen:

1. Ndërmarrjet mikro prej 0-9 punëtor
2. Ndërmarrjet e vogla prej 10-49 punëtor

I. KRITERET E GRANTIT: Lot I

1. Përfituesi duhet të regjistrohet në Zyrën për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK) në Komunë të Gjakovës dhe të operojë në Komunën e Gjakovës, ku edhe duhet të bëhet investimi
2. Të gjeneroj punësim me marrjen e grantit;
3. Aplikuesit të cilët promovojnë ide kreative dhe inovative në tregun tonë do të kenë përparësi
4. Përparësi kanë aplikuesit nën moshën 35 vjeçare, gratë, të rinjtë, nga komunitetet pakicë si dhe bizneset prodhuese/përpunuese që eksportojnë, të cilët nuk kanë përfutuar asnjëherë nga fondet e Komunës së Gjakovës

5. Në momentin e kompletimit të dokumentacionit aplikuesi duhet të dorëzojë Profaturën/Ofertën për pajisjet dhe mjetet e punës të planifikuara për investim
6. Aplikuesit duhet të kontribuojnë me vetëfinancim, më së paku më **20%** të vlerës totale të projektit, varësisht nga kostoja e pajisjes.

II. KRITERET E GRANTIT: Lot II

1. Bizneset duhet të jenë të regjistruara në ARBK dhe të operojnë në Komunën e Gjakovës, ku edhe duhet të bëhet investimi
2. Biznesi duhet të ketë të punësuar së paku **NJË** punonjës përveç pronarit.
3. Të gjeneroj punësim me marrjen e grantit
4. Bizneset duhet të dëshmojnë se janë funksionale, të qëndrueshme në treg dhe kanë kapacitet të mjaftueshëm për zgjerimin e prodhimit, qarkullimit dhe rritjen e numrit të punonjësve. *Këtë e dëshmojnë përmes deklarimeve të ATK-së qarkullimi vjetor për vitin 2024.*
5. Bizneset të cilat promovojnë ide kreative dhe inovative në tregun tonë do të kenë përparësi
6. Përparësi kanë bizneset që udhëhiqen nga gratë, të rinjtë nën moshën 35 vjeçare, nga komunitetet pakicë, dhe ato biznese të cilat nuk kanë përfituar asnjëherë nga fondet e Komunës së Gjakovës
7. Në momentin e aplikimit biznesi duhet të dorëzojë Profaturën/Ofertën për pajisjet dhe mjetet e punës të planifikuara për investim
8. Bizneset duhet të kontribuojnë me vetëfinancim, më së paku më **20%** të vlerës së grantit të fituar, varësisht nga kostoja e pajisjes, dhe nga vlera e grantit të fituar
9. Bizneset duhet të dëshmojnë se i kanë të paguara obligimet ndaj ATK-së, Tatimit në pronë dhe Taksës në firmë për vitin 2024 dhe kësti i I-rë 2025

II. ÇFARË FINANCOHET NGA GRANTI: Lot I dhe Lot II

1. Blerja e pajisjeve dhe mjeteve të punës duhet të jenë të reja

III. KRITERET JOKUALIFIKUESE: Lot I dhe Lot II

Aplikantët potencial nuk mund të marrin pjesë në këtë thirrje apo të përfitojnë grant nëse gjenden në ndonjërin prej situatave që renditen si më poshtë:

1. Bëjnë pjesë në njërin prej veprimtarive si: tregtia (me pakicë e shumicë), ndërtimtaria, shëndetësia, bujqësi dhe sallonet e ondulimit
2. Paraqet veti diskriminuese apo ka ndikim negativ në shoqëri dhe komunitet
3. I shkakton dëme ambientit apo ndonjë grupi tjetër të marginalizuar
4. Keni qenë përfitues të Granatit në 2 vitet e fundit nga DZHE- Komuna e Gjakovës
5. Ka orientime apo qëllime politike
6. Kërkon grante për të blerë tokën për ndërtim
7. Merret me tregtimin e produkteve
8. OJQ-të nuk kanë të drejtë të aplikojnë
9. Keni bërë ndryshim në biznes pas datës së shpalljes publike për Aplikim
10. Nëse vlera e financimit të projektit është nën ose mbi shumën e vlerës që financohet nga Komuna
11. Nëse mungon një nga dokumentet e kërkuara për aplikim

IV. PROCEDURA E APLIKIMIT

Forma e Aplikacionit mund të merret duke klikuar në web-faqen zyrtare të Komunës në linkun: <https://kk.rks-gov.net/gjakove/category/konkurset-njoftimet/aplikacione/> , si dhe i njëjti mund të merret pranë Qendrës për Informim në objektin e Komunës së Gjakovës.

Pasi ta keni plotësuar aplikacionin, së bashku me dokumentacionin mbështetës që kërkohet, duhet të aplikoni në formën fizike në zyrën e Arkivës të Komunës së Gjakovës, ku protokollohet dokumentacioni dhe ju do të merrni numrin e protokollit, që dëshmon se JU KENI APLIKUAR.

Një aplikant nuk mund të dorëzojë më shumë se një aplikacion në këtë thirrje.

V. AFATI I APLIKIMIT:

Afati i aplikimit është 11 Mars deri më 31 Mars 2025

Dëgjimi publik mbahet më datë 20 Mars në sallën e Kuvendit Komunal (Pallati i Kultures "Asim Vokshi") në ora 10:30

VI. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM: Lot I

1. Aplikacioni
2. Kopja e letërnjoftimit
3. Oferta/Profaturë me të gjitha shënimet e duhura që specifikon pajisjet apo mjetet e punës me çmimin përkatës
4. Referencë, certifikatë, trajnime (Opsionale)
5. Deklarata nën betim e aplikuesit

VII. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM: Lot II

1. Aplikacioni
2. Kopja e letërnjoftimi
3. Kopja e Certifikatës së Biznesit me të gjitha informatat përcjellëse (certifikata duhet të jetë e re, lëshuar nga ARBK sipas numrit unik identifikues)
4. Deklarata vjetore e qarkullimit e raportuar në ATK për vitin 2024.
5. Listën e punëtorëve për vitin 2024 dhe 2025 të lëshuar nga ATK (mund të nxjerrët online nga web-faqja e ATK-së)
6. Oferta/Pro faturë me të gjitha shënimet e duhura si: numri i regjistrimit të biznesit, numri i pro faturës, emri i plotë i furnitorit (shitësit), adresa e saktë, nënshkrimi dhe vula e shitësit, dhe të gjitha të dhënat tjera të rëndësishme për furnitorin ku do të blihet pajisja/et, specifikacionin dhe fotot e pajisjeve apo mjeteve të punës me çmimin përkatës
7. Vërtetimi i ATK-së, Tatimit në pronë dhe Taksës në firmë.
8. Konfirmimi bankar i biznesit
9. Deklarata nën betim të pronarit/aplikuesit
10. Bizneset që eksportojnë prodhimet e tyre duhet të dëshmohet me DUD doganor.
11. Pëlqim sanitar i vlefshëm.

VIII. PROCEDURAT E VLERËSIMIT:

Faza e parë e vlerësimit të aplikacioneve do të përfshijë një "kontroll administrativ" për të siguruar që aplikantët kanë përmbushur rregullat e kualifikimit dhe dokumentet e kërkuara për aplikim. Përderisa, faza e dytë dhe përfundimtare përfshin vlerësimin përmbajtësor të aplikimit duke u bazuar në kriteret përzgjedhëse dhe nëse ndërmarrja ka perspektivë të mirë të të qenit e suksesshme dhe e qëndrueshme, si dhe që implementimi do të kontribuojë drejt përmbushjes së qëllimit të Thirrjes për Grante. Grantet do t'i jepen aplikantëve me më shumë pikë të mbledhura.

IX. FORMA E PAGESËS SË GRANTIT:

Shuma e financimit të fondeve publike komunale për grante ndahet në dy Lot-e

Lot I {Start-Up} shuma totale e fondit 30,000.00 €

Lot II {Bizneset Ekzistuese} shuma totale e fondit 120,000.00 €

Grantet jepen në formën e parave të gatshme, pasi që biznesi sjell dëshminë respektivisht faturën e rregullt për blerjet (investimet) që i ka bërë, e të cilat duhet të jenë në përputhshmëri të plotë me kërkesën për investim që e ka dëshmuar me profaturë/ofertë.

SQARIM PËR START-UP:

Pas publikimit të listës përfundimtare për start-up, përfituesit janë të obliguar të regjistrojnë veprimtarinë biznesore si entitet ligjor në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës, para nënshkrimit të kontratës.

Përfituesi duhet të hap xhirollogarinë në emër të Biznesit.

SQARIM: Nëse zgjidheni përfitues i grantit, atëherë nënshkruhet Kontrata me Komunën/DZHE dhe pastaj duhet të sjellet **Fatura dhe Transferi Bankar** e bërë nga xhirollogaria e biznesit tuaj tek operatori ekonomik (shitësi), me të cilën dëshmohet blerja e pajisjes/ve. Atëherë Komuna e bënë rimbursimin e mjeteve financiare në vlerën e grantit.